



Programi për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe parandalimin e përmytjeve në Shqipëri

Editorial

Shqipëria është prekur ndjeshëm nga përmytjet përgjatë muajve të fundit. Ngjarjet e dhjetorit të vitit të kaluar si dhe në fillim të këtij viti janë tregues i qartë i rrezikut nga përmytjet, të cilat mund të konsiderohen tashmë si mëse të zakonshme edhe për vendin tonë. Mijëra hektarë toke të përmytur, qindra kafshë të ngordhura, dyzina familjesh të shpërngulura, janë këmbana të forta alarmi që na kujtojnë se duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi informimit, parapërgatitjes dhe marrjes së masave të nevojshme, në kohën e duhur.

Në këtë kontekst, programi PRO NEWS ka parashikuar një seri aktivitesh nën secilin komponent të tij, duke synuar rritjen e aftësive ripërtëritëse ndaj përmytjeve dhe të parandalimit të fatkeqësive natyrore, në përputhje me Praktikën e Mira të Bashkimit Evropian.

Në këtë buletin, do mund të lexoni mbi kontributin e dhënë për rritjen e kapaciteteve planifikuese për menaxhimin e emergjencave, përmes Vlerësimit të Planeve të Emergjencave në nivel Prefekturë; mbi mbështetjen ndaj institucioneve shqiptare për anëtarësimin në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian; mbi vlerësimin e stacioneve automatike të motit dhe të aktiviteteve për rikuperimin e të dhënave ndër vite.

Lexim të këndshëm!

Në këtë numër:

Vlerësimi i Planeve për Emergjencat në nivel Prefekturë



Mbështetja e institucioneve Shqiptare për anëtarësimin në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së

Vlerësimi i stacioneve hidrologjike dhe detare të parashikimit automatik të motit

Rikuperimi i të dhënave klimatike dhe hidrologjike



Rritja e kapaciteteve për menaxhimin e planifikimit të emergjencave Vlerësimi i Planeve të Emergjencave në nivel Prefekturë


Një nga komponentët e programit PRO NEWS (Komponenti B: Rritja e kapaciteteve për menaxhimin e planifikimit të emergjencave) fokusohet në dhënien e asistencës Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në Shqipëri, për të analizuar planet ekzistuese për emergjencat në nivel prefekturë. Një analizë e tillë bëhet në kuadër të homogjenizimit dhe të koordinimit të sistemit të përgjithshëm të planifikimit dhe menaxhimit të emergjencave në Shqipëri.

Në këtë kuadër, puna në vitin e parë u përqëndrua në analizimin dhe hartimin e një metodologjie vlerësimi për të analizuar planet dhe për të identifikuar praktikatat e mira dhe mangësitë, me qëllim për të mbështetur hartimin e udhëzimeve të reja për planifikimin e emergjencave. Vlerësimi është realizuar ndërmjet partnerëve të konsorciumit PRO NEWS (DPC, CIMA, REC) dhe përfituesëve (DPEC dhe Prefekturat).



Nga workshopi "Një hap më tej në Planifikimin për Emergjencat"

COMPONENT		SCORE
A. ACTUALITY OF THE PLAN	✓✓	3.6
B. RISK SCENARIOS	✓✓	4.0
C. REAL-TIME MONITORING ACTIVITIES	! ?	2.5
D. ALERT SYSTEM	! ?	2.0
E. INTERVENTION MODEL	✓✓	3.0
F. OPERATIONAL PHASES	✓✓	4.0
G. INFORMATION AND COMMUNICATION TO POPULATION	! ?	2.0
H. EXERCISES	! ?	2.0



Një nga vlerësimet e planeve, i përfaqësuar me tabelë rezultatesh

Referenca bazë për këtë punë kanë qenë udhëzimet e PNUD-it për planifikimin e emergjencave të vitit 2003, kuadri ligjor i Shqipërisë, udhëzimet e BE-së dhe praktikatat e mira të vendeve anëtare të BE-së. Në ato raste kur mungonin ligjet Shqiptare (p.sh. sistemi i alarmit), janë përdorur si referencë kuadri ligjor i vendeve anëtare të BE-së ose udhëzimet e BE-së.

Analiza ka nxjerrë një rezultat të dyfishtë (i) një sistem i thjeshtë me të cilin verifikohet konformiteti i planeve ndaj udhëzimeve ekzistuese, duke theksuar fushat që kërkojnë ndërhyrje urgjente; dhe (ii) një vështrim i përgjithshëm, në nivel prefekturë, i planifikimit për emergjencat në Shqipëri.

Vlerësimi u finalizua gjatë një workshopi të mbajtur në datat 5-6 Tetor 2017, ku përfaqësues nga 12 prefekturat, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile dhe palë të tjera të interesuara u takuan për të shkëmbyer mendimet dhe për të ndarë praktikatat e mira dhe metodologjitë, teksa përfundohej vlerësimi.



Vlerësimi i stacioneve automatike të motit, atyre hidrologjike dhe detare

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) zhvillon vërtetime të motit dhe të dukurive klimaterike e hidrologjike, për të mbështetur parashikimin e motit dhe për të dhënë lajmërimin në kohën e duhur mbi ngjarje të rrezikshme, përfshirë këtu dhe përmbytjet.

Të dhëna të sakta vërtetimi nga stacione automatike të motit, atyre hidrologjike dhe detare, janë thelbësore për këtë qëllim. Për rrjedhojë, ekspertë nga Shërbimi Hidrologjik dhe Meteorologjik i Kroacisë dhe nga Shërbimi Meteorologjik Kombëtar i Turqisë, së bashku me IGJEUM në Shqipëri, zhvilluan një inspektim mbi mënyrën e funksionimit të rrjetit të stacioneve në Shqipëri. Bazuar në inspektimin e stacioneve, është e qartë se një pjesë e madhe e stacioneve automatike kanë nevojë për rehabilitim. Disa stacione detare dhe hidrologjike janë tërësisht të shkatërruar si pasojë e vandalizmit, vjedhjes ose përmbytjeve. Stacionet e tjera kanë nevojë për pajisje të reja, mirëmbajtje, rikalibrim të instrumenteve ekzistuese, ose përmirësim të infrastrukturës së tyre.

Bazuar në inspektimin në terren të stacioneve, plani i rehabilitimit të tyre do të hartohet me mbështetjen e programit PRO NEWS, në kuadër të Komponentit D: Përmirësimi i Paralajmërimit të Hershëm ndaj Përmbytjeve dhe Përfshirja në Sistemin Evropian të Ndërgjegjësimit. Një numër i caktuar stacionesh automatike do të rehabilitohen për të siguruar disponueshmërinë e vazhdueshme të të dhënave të sakta vërtetuese.

Rikuperimi i të dhënave klimatike dhe hidrologjike

Disponueshmëria e të dhënave historike klimatike është thelbësore për të kuptuar klimën dhe se si ajo ndryshon me kalimin e kohës. Për më tepër, informacioni mbi ekstremet e motit është i rëndësishëm për të kuptuar dhe për t'u përgatitur ndaj rreziqeve të lidhura me ngjarjet e rrezikshme meteorologjike dhe hidrologjike.

Përpjekjet për rikuperimin e të dhënave janë të rëndësishme veçanërisht kur të dhënat historike rrezikojnë të humbasin si pasojë e dëmtimit të shënimeve të arkivuara. Prandaj, është i domosdoshëm dixhitalizimi i të dhënave në formë elektronike, lehtësisht të aksesueshme.

Si pjesë e asistencës nga Komponenti D i programit PRO NEWS, një ekip ekspertësh është angazhuar për rikuperimin e të dhënave dhe 6 laptopë të rinj i janë dhuruar Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit për këtë qëllim. Ekipi do të punojë për ruajtjen elektronike të të dhënave klimatike dhe hidrologjike që janë aktualisht të disponueshme në IGJEUM, në format të shkruar. Të dhënat e dixhitalizura mund të përdoren në modelimin e parashikimit të përmbytjeve dhe eventeve hidrologjike në të ardhmen.



Mbështetje institucioneve shqiptare për anëtarësim në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (UCPM)

Mbështetja për anëtarësim në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian përfshin dhënien e ndihmës qeveritare menjëherë pas ndodhjes së një fatkeqësie natyrore. Një përgjigje e mirë-koordinuar evropiane është e domosdoshme për të shmangur përjekjet e dyfishta rimëkëmbëse dhe për të siguruar që asistencë e siguruar përmbush nevojat e vërteta të shtetit të prekur nga fatkeqësia natyrore.

UCPM-ë është i hapur për përfshirjen e “shteteve aderuese, vendeve kandidate apo potencialisht kandidate”. Në këtë kuadër, programi PRO NEWS, përmes Komponentit F: Mbështetje institucioneve shqiptare për anëtarësim në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, po mbështet Shqipërinë në procesin e anëtarësimit në UCPM-ë.

Së fundmi, programi PRO NEWS dhe Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile në Shqipëri (DPEC) kanë diskutuar një Plan Veprimi që synon të udhëzojë Shqipërinë drejt anëtarësimit në UCPM-ë. Plani është përgatitur duke patur në fokus të tij adresimin e një game të gjerë kriteresh bazë jologjore dhe kapacitetesh të përcaktuara në nivel Bashkimi Evropian për vendet anëtare të UCPM-së. Ndër të tjera, kriteret jologjore për anëtarësimin në UCPM-ë përfshijnë respektin për parimet bazë të bashkëpunimit, të sinqeritetit, të transparencës dhe të shkëmbimit mes kolegëve; funksionimin e një pike kontakti për 24 orë në 7 ditë të javës (24/7), e cila mund të komunikojë në anglisht; lidhjen me Sistemin e Përbashkët për Informimin dhe Komunikimin e Emergjencave (CECIS); mundësimin e shërbimeve kombëtare për paralajmërimin e hershëm dhe shkëmbimin e informacionit mbi operacionet e zhvilluara në vendet anëtare të UCPM-së, si dhe pjesëmarrjen në proceset e UCPM-së mbi “nxjerrjen e mësimëve”; hartimin e vlerësimeve të rrezikut dhe kontributin financiar ndaj UCPM-së.



© Vladimir Rodas

Hartimi i Planit të Veprimit bazohet në supozimin se ekziston vullneti politik i autoriteteve përgjegjëse shqiptare për t'u anëtarësuar në UCPM-ë. Thënë kjo, duhen ndërmarrë një sërë masash në vend, në mënyrë që Shqipëria të plotësojë kriteret e UCPM-së, përfshirë këtu edhe përmes mbështetjes dhe asistencës teknike të mundësuar nga komponentë të ndryshëm të programit PRO NEWS.

Për Shqipërinë, anëtarësia në UCPM-ë do të kontribuonte në krijimin e mundësive të reja për të përforcuar sistemin kombëtar të mbrojtjes civile, si në nivel politik, ashtu dhe në kuadër të përgatitjes dhe të parandalimit të fatkeqësive. Këtu vlejnjë për t'u përmendur: pjesëmarrja e Drejtorëve-Gjeneralëve në takimet e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe në grupet e punës së ekspertëve, përfshirja në trajnimet e UCPM-së dhe në programet e shkëmbimit të ekspertëve dhe ushtrimet përgatitore, pjesëmarrja në takime për shqyrtimin e menaxhimit të fatkeqësive, dhe thirrja për propozime në fushën e përgatitjes dhe të parandalimit të fatkeqësive.

Ndriqni programin në: